

AIDA hap Thirrjen: “FONDE MBËSHTETËSE PËR BIZNESET (2026)” 11 Maj

Gjatë muajit Maj 2026, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, shpalli zyrtarisht thirrjen për aplikime për Skemën e Mbështetjes Financiare për vitin 2026, të financuar nga buxheti i shtetit. Kjo thirrje synon mbështetjen e drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për rritjen e konkurrueshmërisë në treg, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, inovacionin, modernizimin e teknologjisë, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre performuese.

Propozimet duhet t'i përmbahen kritereve dhe kushteve të veçanta, të bëra publike në faqen zyrtare të AIDA-s.

ÇFARË OFRON SKEMA?



Financim deri në 100% të kostove të miratuara



Deri në 2,500,000 lekë për projekt



Financim nga buxheti i shtetit

Afati 30 ditë



**11 Maj - 09 Qershor 2026
Ora 16:30**

KUJDES: Nga ky fond nuk mund të përfitojnë ndërmarrjet që kanë marrë financime nga donatorë apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për të njëjtat aktivitete apo shpenzime.

Për më shumë informacion mbi thirrjen dhe dokumentacionin, vizitoni linkun:
<https://aida.gov.al/nmvm-eksporte/nmvm/fondet-e-aida-s/>

Për të shkarkuar broshurën e plotë dhe dokumentacionin teknik, vizitoni linkun:
<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/05/AIDA-Thirrja-2026.pdf>

Ky është rasti juaj më i mirë për të rritur biznesin tuaj me mbulim 100% të kostove.

Sesione informuese “Mbështetje me Fonde për Zhvillimin e Biznesit” 2026

Në kuadër të promovimit të kësaj thirrjeje, gjatë muajit Maj u organizuan dhe u përmbyllën me sukses dy sesionet e para informuese pranë zyrave qendrore të AIDA-s. Të dyja takimet shënuan një interes mjaft të lartë dhe pjesëmarrje aktive nga ana e përfaqësuesve të NMVM-ve. Gjatë këtyre sesioneve, fokus i veçantë iu dedikua bashkëbisedimit dinamik, ku përfaqësuesit e AIDA-s sqaruan specifikat teknike, kriteret e përfitimit dhe hapat praktikë të aplikimit. Përmes trajtimit të rasteve konkrete dhe pyetjeve të ngritura nga subjektet, u ofruan zgjidhje dhe udhëzime të qarta me qëllim realizimin e aplikimeve sa më cilësore. Agjencia rikonfirmoi angazhimin dhe gatishmërinë e saj të plotë për të asistuar bizneset hap pas hapi deri në përfundim të procesit.



AIDA në Forumin Ekonomik Shqipëri – Maqedoni e Veriut | 12 Maj, Shkup

Në 12 Maj, në Shkup, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në forumin "Beyond Borders", një platformë kyçe për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe krijimin e urave të reja të komunikimit mes bizneseve të të dy vendeve.

Në këtë forum morën pjesë personalitete si Ambasadori Denion Meidani, Zv. Kryeministri Aleksandar Nikolovski dhe përfaqësues të dhomave të tregtisë.

Në panelin diskutues "Investment Opportunities: From Potential to Partnership", Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Plaku, vlerësoi rritjen rekord të investimeve maqedonase në Shqipëri si dhe stokut që arritën në vlerën rekord në fund të vitit 2025. Pjesë e paneleve ishin edhe Zv. Ministri z. Endrit Yzeiraj, Zv. Ministra znj. Edona Bilali, si dhe drejtues të tjerë të agjencive investuese, ku u theksua potenciali i 319 kompanive maqedonase në Shqipëri dhe mundësitë për partneritete të reja në energji, turizm dhe teknologji.

AIDA mbetet partneri kryesor institucional, duke ofruar mbështetje për të promovuar Shqipërinë si një destinacion konkurrues dhe të qëndrueshëm në rajon.




AIDA dhe AKT nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi | 8 Maj 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, me synim forcimin e bashkëpunimit për promovimin dhe lehtësimin e investimeve në sektorin e turizmit në Shqipëri.

Kjo marrëveshje synon të nxisë investimet vendase dhe të huaja në zhvillimin e infrastrukturës turistike, produkteve inovative dhe destinacioneve të reja turistike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë si destinacion investimesh dhe turizmi.

Nje hap i rëndësishëm drejt forcimit të sinergjisë institucionale dhe krijimit të më shumë mundësive për zhvillimin e sektorit turistik në Shqipëri.



AIDA pjesë e "MUZA Fashion Fair 2026" | 18 Maj 2026, Tiranë

AIDA ishte pjesë e rrugëtimit 3-ditor plot stil, inovacion dhe mundësi të reja partneriteti për industrinë e modës dhe sektorin kreativ në vend. Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, moderoi diskutimet në Panelin e Parë: "Institucionet & Zhvillimi i Industrisë", ku së bashku me drejtues të lartë institucionale dhe përfaqësues të dhomave të tregtisë, u analizuan hapat për ndërkombëtarizimin e markave shqiptare.

Sfidat e eksportit, lidhja e talentit me sipërmarrjen dhe krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm ekonomik ishin në qendër të vëmendjes. Moda shqiptare tashmë po shihet si një segment me vlerë të lartë të shtuar për ekonominë dhe eksportet tona. AIDA mbështet rritjen dhe ndërkombëtarizimin e industrisë kreative në "MUZA Fashion Fair 2026"



AIDA në Forumin e Bizneseve Shqipëri-Greqi | 23 Maj 2026, Athinë

Në kuadër të Forumit të Bizneseve Shqipëri-Greqi, u bashkuan institucione, sipërmarrës dhe partnerë strategjikë për të diskutuar mbi forcimin e bashkëpunimit ekonomik, promovimin e investimeve dhe krijimin e mundësive të reja mes dy vendeve. AIDA ishte pjesë e këtij Forumi që u zhvillua në Athinë me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë. Forumi mbledhi përfaqësues institucionale dhe aktorë të rëndësishëm ekonomikë nga të dy vendet, duke krijuar një hapësirë diskutimi mbi mundësitë e reja për bashkëpunim, investime dhe zhvillim të lidhjeve ekonomike mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Një moment i rëndësishëm i vizitës ishte takimi i AIDA-s me homologen e saj Enterprise Greece, i cili rikonfirmoi bashkëpunimin e konsoliduar mes dy institucioneve. Gjatë takimit u diskutua mbi pjesëmarrjen në evente ndërkombëtare, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e takimeve të ardhshme në Tiranë, si një hap i mëtejshëm për krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim mes dy agjencive.



AIDA në Konferencën e organizuar nga Konrad Adenauer Stiftung dhe Alumni BBUGA | 1 Maj 2026

AIDA mori pjesë në Konferencën e organizuar nga Konrad Adenauer Stiftung dhe Alumni BBUGA për të diskutuar mbi potencialin ekonomik të Shqipërisë, mundësitë e investimit dhe perspektivën e integritimit evropian.

Në panelin "A është Shqipëria gati për Evropën?! Si po përgatiten Shqipëria dhe vendet fqinje për anëtarësimin në Bashkimin Europian", Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro evidentoi katër shtylla kryesore për digjitalizimin dhe lehtësimin e të bërit biznes ku AIDA luan rol kyç në mbështetje, koordinim dhe dialog publik-privat.

"Shqipëria nuk po pret thjesht të anëtarësohet në BE, por po ndërton gradualisht themelet e një ekonomie të integruar evropiane"- theksoi znj. Saro



EEN2EIC Workshop Session | 7 Maj 2026

Më 7 Maj, AIDA organizoi me sukses sesionin trajnimos në kuadër të iniciativës EEN2EIC, duke bërë bashkë 21 biznese nga sektorë të ndryshëm për të eksploruar mundësitë e financimit, investimit dhe rritjes në tregjet europiane. 🇪🇺

Përmes ekspertizës së ofruar nga ekspertët e Easy Solution, Z.Sabi Osmani dhe Z.Erion Nako, pjesëmarrësit u njohën me praktikat më të mira për:

- përgatitjen për pritjen e investitorëve,
- strategjitë e komunikimit dhe matchmaking,
- aksesin në instrumentet e financimit të EIC,
- dhe rritjen e kapaciteteve inovative të biznesit.

Ky workshop shërbeu si një hap i rëndësishëm për forcimin e ekosistemit të inovacionit dhe mbështetjen e SME-ve shqiptare drejt ndërkombëtarizimit dhe investimeve strategjike.



Exportet në Shqipëri | Prill 2026 në nivele rekord

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, eksportet e mallrave në muajin Prill 2026 arritën vlerën 34,9 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 16,9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe 6,8% më shumë krahasuar me Marsin 2026.

Rritja e eksporteve është ndikuar kryesisht nga sektorët:

- Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike
- Materiale ndërtimi dhe metale
- Ushqime, pije dhe duhan
- Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi, etj.

Partnerët me rritjen më të lartë të eksporteve shqiptare rezultojnë:

- Kosova me 26,0%
- Gjermania me 28,9%



Vendet e Bashkimit Evropian vijojnë të mbeten partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, duke zënë 53,8% të tregtisë totale, ndërsa eksportet drejt BE-së përbëjnë 62% të eksporteve gjithsej.

Në mbështetje të ndërmarrjeve shqiptare që synojnë zgjerimin në tregjet ndërkombëtare, AIDA ka vënë në dispozicion edhe Platformën e Eksporteve, <https://exportalbania.al/>, ku bizneset shqiptare me krijimin e një profili në platformë mund të promovojnë produktet dhe shërbimet "Made in Albania" në tregjet globale. Platforma u ofron subjekteve mundësinë për të rritur vizibilitetin ndërkombëtar, për të identifikuar partnerë potencialë, distributorë apo blerës të huaj, si dhe akses në mjete dhe informacione mbi tregjet e eksportit.

AIDA mbetet e angazhuar në mbështetjen e ndërmarrjeve shqiptare për rritjen e eksporteve, zgjerimin në tregjet ndërkombëtare dhe promovimin e produkteve shqiptare.

Marrëveshje mes AIDA-s dhe DevelopmentAid

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka nënshkruar zyrtarisht një marrëveshje partneriteti me DevelopmentAid.

Përmes këtij bashkëpunimi, kompanitë dhe institucionet lokale fitojnë akses të zgjeruar në mundësitë ndërkombëtare të financimit, inteligjencën e tregut dhe partneritetet strategjike – duke i ndihmuar ato të zgjerojnë praninë e tyre në tregjet globale.

Për më shumë informacion klikoni këtu: <https://slink.com/zrxwj31>

Le të nxisim së bashku rritjen e qëndrueshme, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.



Takim mes AIDA-s dhe partnerëve ndërkombëtarë të General Assembly | 5 Maj

AIDA zhvilloi një takim për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit me General Assembly dhe partnerët e saj ndërkombëtarë, në funksion të zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe rritjes së atraktivitetit të Shqipërisë për investime.

General Assembly, në partneritet me Albanian-American Development Foundation (AADF) dhe Protik Innovation Center, ka nisur një bashkëpunim strategjik trevjeçar për zhvillimin e aftësive digjitale në Shqipëri, duke ofruar programe trajnimi në fusha si inteligjenca artificiale, zhvillimi i programeve dhe teknologjitë e edukimit.

Në këtë kuadër, u diskutua roli i mundshëm i AIDA-s në mbështetjen e këtij ekosistemi përmes promovimit të Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investime në sektorin e teknologjisë dhe zhvillimit të aftësive, si dhe në krijimin e urave lidhëse midis talenteve lokale dhe tregut ndërkombëtar të punës.



THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI - Forumi Ekonomik Poloni-Shqipëri

Në kuadër të Sesionit të 8-të të Komisionit të Përbashkët Ekonomik Poloni-Shqipëri, do të organizohet një Forum Ekonomik me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe të biznesit nga të dy vendet.

Vendndodhja: Varshavë, Poloni
Datat: 18–19 Qershor 2026

Thirrje për bizneset: Sektori i Ndërtimit

Kompanitë shqiptare të ndërtimit kanë dëshmuar tashmë kapacitete të larta në tregun vendas, por hapi tjetër është zhvillimi i qëndrueshëm urban me standarde evropiane. Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri-Poloni, AIDA ju fton të bëheni pjesë e këtij misioni tregtar në Poloni për të krijuar konsorciume dhe Joint Ventures me kompani polake të specializuara në infrastrukturë madhore.

Ky forum shërben si një tryezë pune e nivelit të lartë ku sipërmarrja juaj mund të bashkojë kapitalet dhe ekspertizën për projekte me rëndësi strategjike.

Thirrje për bizneset: Industria Ushqimore & Agrobiznesi

Në kuadër të Forumit Ekonomik Poloni-Shqipëri, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të industrisë ushqimore dhe agrobiznesit të bëhen pjesë e delegacionit zyrtar në Varshavë. Produktet "Made in Albania" kanë potencial të rrisin praninë e tyre në tregun evropian përmes partneriteteve të reja dhe zgjerimit të bashkëpunimeve tregtare. Forumi ekonomik do të ofrojë mundësi për lidhje direkte me distributorë dhe importues polakë si dhe zgjerimin e rrjetëve tregtare ndërkombëtare.

Thirrje për bizneset: Sektori i Energjisë

Tranzicioni drejt energjisë së gjelbër kërkon partneritete strategjike dhe investime të qëndrueshme. Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri-Poloni, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare që operojnë në fushën e energjisë, burimeve të rinovueshme dhe infrastrukturës energjetike të bëhen pjesë e delegacionit zyrtar në Varshavë.

Forumit ekonomik do të ofrojë mundësi për takime me kompani dhe liderë polakë të teknologjisë energjetike si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira evropiane në sektorin energjetik.

Thirrje për bizneset: Sektori ICT / BPO

Në kuadër të Komisionit të Forumit Ekonomik Shqipëri-Poloni, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të sektorit ICT dhe BPO të bëhen pjesë e delegacionit zyrtar në Varshavë. Shqipëria po konsolidohet gjithnjë e më shumë si një qendër në zhvillim për inovacionin teknologjik dhe shërbimet digjitale në rajon.

Forumit ekonomik do të krijojë mundësi për bashkëpunime në fushën e outsourcing dhe shërbimeve digjitale si dhe Integrimin në rrjetet globale të teknologjisë dhe inovacionit.

Varshavë, Poloni
19 Qershor 2026

Kompanitë e interesuara mund të dërgojnë shprehjen e interesit në: info@aida.gov.al

Biznese që rriten me Mbështetjen e AIDA

Zdrava Group

Zdrava Group – Një aktor i rëndësishëm në tregun vendor, ballkanik dhe europian.

E themeluar në vitin 1992 në Lushnjë nga vëllezërit Zdrava, Zdrava Group është një histori suksesi e ndërtuar mbi traditën familjare dhe produktet bio shqiptare.

Nga Lushnja në Tiranë, e më pas në Prishtinë, Beograd, Sofje, Romë, deri në Shtetet e Bashkuara dhe vendet skandinave, Zdrava Group ka zgjeruar prezencën e saj ndërkombëtare, duke dëshmuar rritje të qëndrueshme dhe konkurrueshmëri në rritje.


Ky zhvillim përfaqëson një shembull të qartë të potencialit të sipërmarrjes shqiptare, të cilin AIDA e mbështet dhe promovon në mënyrë të vazhdueshme, duke nxitur zgjerimin e bizneseve vendase në tregjet globale.

Publikime AIDA : "Start a Business IN Albania"

AIDA ka kënaqësinë të prezantojë një botim të ri, broshurën "Start a Business in Albania". Kjo broshurë shërben si një udhëzues praktik dhe ndërveprues për investitorët dhe sipërmarrësit që duan të nisin një aktivitet ekonomik në Shqipëri. Ky material thjeshton të gjithë rrugëtimin administrativ dhe ligjor përmes kodeve QR, duke ofruar një pikë të vetme kontakti orientues. Ai redukton kohën dhe siguron një pasqyrë të qartë të detyrimeve dhe avantazheve operacionale përpara hedhjes së hapave të parë në tregun shqiptar.

AIDA ju fton të konsultoni manualin përmes linkut:

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/05/One-Page-1.pdf>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: EWA Open Call 2026 (Agro-ushqimore)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: EWA Open Call 2026 (Agro-ushqimore)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/ewa-open-call-2026>



AIDA ju fton të merrni pjesë në : CIEPEC 2026 , Kinë

Njoftim për pjesëmarrje në Konferencën dhe Ekspozitën e 24-të Ndërkombëtare CIEPEC 2026, Pekin, Kinë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon kompanitë, institucionet dhe organizatat shqiptare që operojnë në sektorët e mjedisit, teknologjive të gjelbra, menaxhimit të mbetjeve, trajtimit të ujërave dhe energjisë së rinovueshme mbi mundësinë për pjesëmarrje në Konferencën dhe Ekspozitën e 24-të Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit – China International Environmental Protection Exhibition and Conference (CIEPEC 2026), e cila do të zhvillohet në datat 2–4 qershor 2026, në Pekin, Kinë.

Aktiviteti organizohet nga China International Association of Environmental Protection Industry (CAEPI) dhe Zyra e Sekretariatit të Bashkëpunimit Kinë-VEQL, dhe do të fokusohet në prezantimin e teknologjive dhe zgjidhjeve inovative për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Organizatorët bëjnë me dije se pjesëmarrësit nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore përfitojnë përjashtim nga tarifa e pjesëmarrjes në ekspozitë.

Për më shumë informacion klikoni në linkun:

<http://ciepec.org/#/headeng>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: MAT4EU Advanced Materials Innovation Open Call

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: MAT4EU Advanced Materials Innovation Open Call

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:
<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/mat4eu-advanced-materials-innovation-open-call>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: Scaling Green Innovation with Industry – Growth Box Call (Green Grid)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Scaling Green Innovation with Industry – Growth Box Call (Green Grid)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:
<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/scaling-green-innovation-with-industry-growth-box-call-green-grid>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: RESIST II Process Innovation Open call

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: RESIST II Process Innovation Open call

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:
<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/resist-ii-eurocluster-process-innovation-open-call>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: PowerUp NetZero - Open call

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: PowerUp NetZero - Open call for Business Innovation and Technology Adoption Services

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:
<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/powerup-netzero-business-innovation-and-technology-adoption-services-open-call>



Ftesë për pjesëmarrje World Halal Summit & Halal Expo 2026 – Turqi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të bëhen pjesë e një prej eventeve më të rëndësishme globale për industrinë Halal, që do të zhvillohet në datat 25–28 Nëntor 2026 në Stamboll, Turqi, nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Turqisë, SH.T.Z. Rexhep Tajip Erdogan.

Në kuadër të World Halal Summit & Halal Expo, kompani nga e gjithë bota mbledhen për të prezantuar produktet e tyre, për të krijuar partneritete strategjike dhe për të zgjeruar praninë në tregjet ndërkombëtare.

Edicioni i vitit të kaluar realizoi:

- Mbi 50,000 vizitorë ndërkombëtarë
- Rreth 500 ekspozues nga mbi 50 vende
- Qindra takime B2B me blerës dhe distributorë globalë
- Akses në tregun global halal me potencial trilionë dollarë

Çfarë përfitoni?

- Ekspozim ndërkombëtar për produktet shqiptare
- Lidhje direkte me partnerë dhe blerës të rinj
- Mundësi për rritje eksportesh
- Pozicionim në një nga tregjet më dinamike në botë

Eventi mbulon sektorë si ushqim & pije, kozmetikë, farmaceutikë, turizëm, financë islame, tekstile dhe më shumë.

AIDA inkurajon kompanitë eksportuese dhe potencialisht eksportuese shqiptare, si dhe organizatat e biznesit, të konsiderojnë pjesëmarrjen në këtë event me impakt të lartë.

Për më shumë informacion: World Halal Summit & Halal Expo 2026

